



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-I-15-0224

Paditësi

F.Xh. Prishtinë, përfaqësuar nga avukati.

Kundër:

Ankuesi/E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Agim Ramadani" 23, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami Gjyqtar Kryesues, Sabri Halili dhe Hajrie Shala, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të DHPGJS-së, C-IV-13-3525 i datës 12 tetor 2015 në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 12 shtator 2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e AKP-së, refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Vërtetohet, Aktgjykimi i Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të DHPGJS-së, C-IV-13-3525 i datës 12 tetor 2015. Pika -II- e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar, ndryshohet dhe zëvendësohet me këtë formulim: "E paditura-AKP-ja, Autoriteti i**

Likuidimit është e obliguar që ta marr në konsideratë padinë e paditësit F.Xh. lidhur me pagat e papaguara në shumë prej 1.969,00 Euro, në procedurën e likuidimit, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj”.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 4 Dhjetor 2013, paditësi F.Xh. në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ka parashtruar ankesë kundër vendimit nr. PRN009-0086 datës 18 nëntor 2013, me të cilin e paditura AKP në Prishtinë – Autoriteti i Likuidimit(më tutje AL), kishte refuzuar kërkesën e ankuesit për kompensim të pagave të papaguara, për periudhën kohore 1 Mars 2007 deri me 31 janar 2008, në shumën prej 1.969.00 euro, për NSH-K.B “B” në Prishtinë (në likuidim).

Në ankesë ka theksuar se pa të drejtë është refuzuar kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara. Ankesës ia ka bashkangjitur vendimin e AL-së kundër të cilit ka paraqitur ankesë, njoftimin e AKP-së për ndërprerjen e marrëdhënies se punës date 31 janar 2008. Dhomës se Posaçme i ka propozuar që vendimi i atakuar të anulohet ndërsa ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të obligohet e paditura që paditësit t’i kompensoj borxhin e kërkuar.

Në mbrojtjen e parashtruar me 12 shtator 2014 e paditura, AKP i propozoi Gjykatës refuzimin e ankesës si të pa pranueshme dhe të pabazuar dhe vërtetimin e vendimit të ankimuar, duke u thirrur në parashkrim të kërkesës sepse duke u bazuar në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar kjo është dashur të bëhet në afat prej 3 vite.

Ankuesi në përgjigjen e tij ndaj mbrojtjes së të paditurës më datë 14 tetor 2014 ka mbetur në tërësi sipas pretendimeve të tij të parashtruara në ankesë duke precizuar edhe njëherë se ankesa e tij është e bazuar në prova të pa kontestueshme dhe Gjykatës i propozon që e njëjta të aprovohet.

Më datë 7 nëntor 2014 e paditura Dhomës së Posaçme i ka parashtruar kundërpërgjigje ndaj përgjegjës së ankuesit dhe nga Dhoma e Posaçme prapë ka kërkuar që ankesa e ankuesit të refuzohet si e pabazuar, dhe të vërtetohet vendimi i AL.

Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, më 12/10/2015 kishte marrë Aktgjykim C-IV-13-3525, në të cilin u vendos që ankesa e ankuesit të aprovohet si e bazuar dhe ta shfuqizoj Vendimin e AL, PRN.009-0086 të datës 18 nëntor 2013. Me këtë Aktgjykim ishte obliguar që ankuesit F.Xh. , në emër të kompensimit për paga të papaguara, t'i paguaj shumën prej 1.969,00 euro në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit.

Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi thuhet, se pas shqyrtimit të gjithanshëm të ankesës, provave të bashkangjitura dhe të mbledhura gjatë procedurës me shkrim, konstatoi se ankesa duhet të aprovohet si e bazuar dhe të shfuqizohet vendimi i Autoritetit të likuidimit, PRN009-0086 datës 18 nëntor 2013

Kolegji ka konstatuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit-Autoriteti i Likuidimit me rastin e vendosjes së kërkesës së ankuesit, pa ndonjë arsye të bazuar e kishte refuzuar kërkesën e tij, dhe me këtë rast nuk kishte dhënë ndonjë arsyetim të bazuar dhe të pranueshëm për Gjykatën.

Gjithashtu Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara ka konstatuar se në mes të palëve nuk është kontestuese dhe e paditura AKP në mbrojtjen e saj nuk e mohon faktin se ankuesi ka punuar në NSH në periudhën kohore 01 mars 2007-31 janar 2008 dhe nuk e kundërshton faktin se atij nuk i është bërë kompensimi i pagave për këtë periudhë dhe shumën e kërkuar të kompensimit.

Kolegji nuk e aprovon mbrojtjen e AKP-se të parashtruar ndaj ankesës se kërkesa është e parashkruar, pasi që e njëjta nuk është dorëzuar në ndonjë gjykatë në afatin prej 3 viteve dhe me këtë rast referimi i të paditurës në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar është i pavend dhe me këtë rast këto dispozita të këtij Ligji nuk mund të zbatohen. Kjo për faktin se çështja e përmbushjes së

kërkesave të punëtorëve është e rregulluar me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit si ligj i posaçëm (Lexspecialis). Pra neni 608 nuk mund të zbatohet për shkak se Ndërmarrja Shoqërore ka qenë nën administrimin e AKP-së dhe punëtorët për plotësimin e kërkesave të tyre të lidhura me punën është dashur ti drejtohen AKP-së, e varësisht nga përgjigja e saj mandej ti drejtohen gjykatës kompetente. E paditura me rastin e njoftimit mbi likuidimin e ndërmarrjes, i ka njoftuar të gjithë kreditorët e interesuar se, për përmbushjen e kërkesave të tyre duhet t'i drejtohen Autoritetit të Likuidimit.

Ankuesi e kishte bërë një kërkesë të tillë, por ajo pa të drejtë ishte refuzuar.

Më 10/10/ 2015, AKP –Autoriteti i Likuidimit(AL) ka parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi, duke e kontestuar dispozitivin dhe arsyetimin e dhënë në këtë Aktgjykim. AL me shumë faqe në ankesë është marrë me "historikun procedural" të Aktgjykimit të kundërshtuar.

AL pretendon se në vendimmarrje gjykata ka përdorur dëshmi nga rastet tjera, pa ia mundësuar AL-së për ta kundërshtuar një dëshmi të tillë, duke iu referuar në këtë rast "listës së pagave të papaguara".

Sipas AL-së, një praktikë e tillë nuk është në përputhje me Ligjin 04/L-003 dhe Ligjin Nr.06/L-006 "Për Procedurën Kontestimore". Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar ka shkelur nenin 48 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033. AL konsideron se në hapësirën kohore ndërmjet tri viteve 01/03.2007 -01/03.2010, paditësi nuk ka parashtruar asnjë padi në DHPGJS për të kërkuar rrogat e tij (në bazë të nenit 4 të Rregullores 2002/13) dhe as e ka ndërprerë parashkrimin në ndonjë mënyrë tjetër kështu që kërkesat e tij ndaj NSH-së janë gjithsesi të parashkruara. Andaj kërkojmë nga Kolegji i Apelit që ta shfuqizojë Aktgjykimin e gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara dhe të gjykoj meritat e rastit të refuzojë ankesën e parashtruesit kundër Vendimit të AL, dhe të vërtetojë Vendimin e AL.

Në përgjigjen e vetë të datës 27/10/2015 ndaj ankesës së AKP-së, Përfaqësuesi i paditësit, përkrah qëndrimin e Gjyqtarit me kompetenca të deleguara të DHPGJSK dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që ta refuzojë ankesën e të paditurës

dhe ta lërë në fuqi Aktgjykimin e Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara, C-IV-13-3525 të datës 12/10/2015.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e pabazuar.

Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 69.1 të Ligjit nr.06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Pretendimi ankimor i AL-së është se, në vendimmarrje, gjykata ka përdorur dëshmi nga rastet tjera, pa ia mundësuar AL-së për ta kundërshtuar një dëshmi të tillë, duke iu referuar në këtë rast "listës së pagave të papaguara".

Kolegji i Apelit konstaton se një pretendim i këtillë nuk është i bazuar për faktin se listën e pagave të papaguara e ka vetë NSH-ja, ku AL është kompetent për të menaxhuar me të gjitha dokumentet dhe dëshmitë e mundshme, e nuk është një dokument të cilin e ka krijuar paditësi, apo personat e tretë.

Pretendimi tjetër ankimor i AKP-së është se gjykata me aktgjykimin e kundërshtuar gabimisht ka vlerësuar se arsyetimi i AL nuk është i bazuar dhe kërkesa e paditësit nuk është parashkuar.

Me njoftimin e datës 31 janar 2008, lëshuar nga paraardhësja e të paditurës (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit - AKM) ankuesi, F.Xh. ishte njoftuar se si rezultat i vërtetimit nga Bordi i AKM-së të kontratës për shitjen e asetëve të NSH-së, punësimi përfundon menjëherë, dhe se njoftimi në fjalë përbënte njoftim zyrtar. Për me tepër shumat ose pagesat e papaguara nga NSH-ja mbeten përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të njoftoheni kur të fillojnë këto procedura. Andaj ky njoftim përderisa ka parashkuar mundësinë e mbetjes borxh ndaj ankuesit dhe kur dihej se i njëjti figuronte në listën e pagave të papaguara me tepër mund të shihet si një bazë për ndërprerjen e afatit të parashkrimit dhe tek paditësi ka krijuar pritshmëri të arsyeshëm se në momentin e fillimit të

procedurës së likuidimit ai mund të parashtrojë kërkesë par kompensimin e pagave të pa paguara.

Ankuesi është njoftuar nga ana e AKP-së se likuidimi i NSH-K.B "B" në Prishtinë ka filluar nga data 04 gusht 2010, në bazë të vendimit të Bordit të AKP-së, dhe se nëse ankuesi ka ndonjë kërkesë ndaj ndërmarrjes së lartpërmendur kërkesën ta parashtroj te Agjencia – Autoriteti i Likuidimit gjer më 16 tetor 2010. Stërzgjatja e procedurave nga e paditura prej momentit të privatizimit te NSH-së 31 janar 2008 e gjerë në momentin e fillimit të likuidimit të NSH-së (04 gusht 2010), dhe pastaj nga kjo e fundit e deri në vendosjen rreth kërkesës se ankuesit nga e paditura, (vendimi i datës 18/11/ 2013), gjithsej mbi 5 vite dhe refuzimi i kërkesës kreditore të ankuesit në emër të parashkrimit është plotësisht i gabuar. Pra e paditura ishte në dijeni që NSH-ja i kishte mbetur borgj ankuesit në emër të pagave të papaguara dhe me veprimet e saj (njoftimet e datave 31 janar 2008 dhe 04 gusht 2010) vetëm sa kishte njohur të drejtën e tij e cila do të mund të realizohej në kuadër të procedurave të likuidimit, e të cilave ju kishte përmbajtur ankuesi plotësisht.

Kolegji i Apelit konstaton se në listën e NSH-K.B "B" në Prishtinë , për rrogat e mbetura e të pa paguara të punëtorëve ankuesi F.Xh. gjendet në numrin rendor 36 dhe atë për pagat nga muaji mars 2007 - janar 2008 në shumën prej 1.969,00 euro.

Kolegji i Apelit ka ndryshuar piken -II- të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar në mënyrën e cekur në pikën e -II- të këtij Aktgjykimi, për shkak se kërkesa e aprovuar për paga në shumën e cekur duhet të trajtohet në procedurë të likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj.

Bazuar në këto arsye që u cekën më lartë, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e AKP-së është e pabazuar, dhe rrjedhimisht vërtetohet Aktgjykimi i kundërshtuar i Kolegjit të Specializuar, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj konform nenit 9.10 të LDHPGJS-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat gjyqësore:

Meqenëse ankuesi ka paguar taksën gjyqësore për parashtrimin e ankesës më 30/10/2015 në lartësi prej 100 euro, nuk ngarkohet me taksë.

U vendos nga Kolegji i Ankesave në DHPGJS, më 12 shtator 2019.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues i Kolegjit të Apelit _____

URDHËR PËR REGJISTRIN

Luteni ta dërgoni këtë Aktgjykim tekë:

- Palët
- Gjyqtari Kryesues i Kolegjit të Specializuar në lëndën ,C-IV-13-3525

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues i Kolegjit të Apelit _____